



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:206354

Datë: 30.06.2023

Numri i dokumentit: 04441651

C.nr.489/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Kosovare Musliu Prokshaj në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit A.S. nga Lagjia P., Komuna e Klinës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit F.B. avokat nga Peja, Rr “Sh.B.”, kundër të paditurës K.K.S., me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson D.S., me objekt të padisë anulimin e vendimit, kthimit në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 20.06.2023, me datë 29.06.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit A.S. nga Klina.
- II. ANULOHET** si i kundërligjshëm vendimi të me nr. protokolli 277/16, dt. 02.02.2016 që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit A.S.
- III. DETYROHET** e paditura K.K.S., me seli në Prishtinë, që paditësit A.S. nga Prishtina, në emër të kompensimit të ardhurave personale për shkak të ndërprerjes së kundërligjshme nga marrëdhënia e punës për periudhën prej datës 02.02.2016 e deri me 30.06.2018 t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 13,041.30 euro, në emër të kontributit pensional në shumën prej 1,450.00 € si dhe në emër të tatimit në pagë shumën prej 733.70 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 02.02.2016 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë të përgjithshme prej 684 Euro, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- V. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit me të cilën ka kërkuar që të kthehet në vendin e punës.

A r s y e t i m

Kërkesa dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi A.S. me adresë Lagjja P., Komuna e Klinës, me datën 09.03.2016, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, në këtë gjykatë ka parashtruar padi për kthim në vendin e punës, si dhe kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të kundërligjshëm nga puna. Me parashtresën e dt. 31.11.2020 paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka bërë rregullimin e padisë, ashtu që ka kërkuar që të anulohet vendimi i dt. 25.01.2016, me nr. protokollit 277/16 e datës, 02.02.2016, kthimin në punë me të drejta dhe detyrime në pozitën Operator në pikën kufitare në Kullë, si dhe kompensimin e pagave nga data e ndërprerjes 02.02.2016 e deri në ditën e skadimit të kontratës me 30.06.2018, në pagë mujore prej 500.00 euro. Në Padi ashtu edhe në parashtresën e dt. 31.11.2020, është thënë se paditësi ka qenë i punësuar në Kompaninë e Sigurime Kosovare, me seli në Prishtinë, i sistemuar në vendin e punës Operator në pikën kufitare në Kullë, ka shtuar se e ka të përtërirë kontratën e punës me të paditurën disa herë, ku me kontratën e punës nr. 934/15 e dt. 02.07.2015, paditësit i vazhdohet marrëdhënia punës deri me 30.06.2018 në vendin e punës Operator i Shitjes së policave kufitare Kullë, me pagë 500.00 euro. Tutje ka shtuar se në janar të vitit 2016, i ofron lidhjen e një kontratë të re e cila ishte e pa favorshme për paditësin, sepse kontrata e re e cila i ofrohej paditësit për nënshkrim e dëmton paditësin për 100.00 euro, dhe paditësi ka refuzuar ta nënshkruaj këtë kontratë, dhe për këtë arsye, e paditura pasi që paditësi ka refuzuar të nënshkruaj kontratën e punës meqë i njëjti kishte kontratë pune të vlefshme deri me 30.06.2018, i lëshohet vendim nga e paditura, tashmë B.K.S., duke e aprovuar refuzimin e të punësuarit A.S., si dhe në pikën II të këtij vendimi i ndërpritet marrëdhënia e punës me BKS-ë, andaj nga të gjitha të lartcekurat konsiderojmë se paditësit i është bërë padrejtësi lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pas pranimit të ekspertizës financiare në këtë çështje kontestimore bënë precizimin e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura BKS me seli në Prishtinë, që paditësin ta kthej në marrëdhënie të rregullt të punës, me të njëjtat të drejta dhe detyrime sipas precizimit të bërë me shkrim, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën për periudhën kohore prej 02.02.2016 deri me dt. 30.06.2018 dhe atë në emër të kontributit pensional të punësuarit, shumën prej 725.00 euro, në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumën prej 725.00 euro, në emër të tatimit në pagë shumën prej 733.70 € dhe në emër të pagave neto në tërësi për paditësin A.S. nga data 02.02.2016 deri me 30.06.2018 në tërësi 13,041.30 euro, krejt me kamatë prej 8%, nga data dita e paraqitjes së padisë e deri në pagën definitive. I njëjti në fjalën përfundimtare ka shtuar se gjatë administrimit të provave dëgjimit të ekspertes si dhe dëgjimit të paditësit, vlerësojnë se është sqaruar baza e kërkesëpadisë, ku i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi sipas precizimit të kërkesëpadisë dhe padisë lidhur me pozitën që kishte paditësi në ditën e largimit nga puna, si dhe lidhur me vlerën e kontestit të bërë me datën 20.06.2023 për shumat e kërkuara.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përfaqësim në tri seanca gjyqësore nga 135.00 Euro, për precizimin e kërkesëpadisë në vlerë prej 104.00 euro, për taksë gjyqësore në shumë prej 25.00 euro total ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve në vlerë prej 534.00 euro.

E paditura përmes përgjegjës në padi të datës 21.01.2019 e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, për faktin se provat e bashkangjitura janë në kundërshtim me gjendjen faktike dhe nuk i vërtetojnë pretendimet e palës paditëse sepse thëniet në padi ndryshojnë plotësisht nga gjendja faktike. Tutje ka shtuar se fillimisht nuk ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës, sikurse pretendon paditësi mirëpo duke i implementuar vendimin e këshillit, Administrativ të Byros Kosovare të

Sigurimeve si rrjedhojë e komplikimeve financiare dhe rekomandimeve të Komitetit për Financa dhe Buxhet. Ka theksuar se Statutit i BKS, Asambleja është organi më i lartë i BKS-së , Asambleja e anëtarëve përbëhet nga përfaqësues të Kompanive të sigurimit , të cilat janë anëtare të BKS-së, çdo anëtare BKS-së, përfaqësohet me një votë në mbledhje . sipas nenit 9, pika 3 të Statutit, parashihet se kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të BKS-Së Është “ Aprovimi i programit të punës dhe buxhetit të BKS-së. Ndërsa Këshilli miraton strukturën e BKS-së. Ku vlen të ceket fakti se është nxjerrë vendimi për ndryshim të kontratave aktuale për shkak të implikimeve financiare, e cila ka rezultuar me uljen e pagës në raport me paditësin ashtu sikurse edhe me punëtorët e tjerë, e assesi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, mirëpo refuzimi i nënshkrimit të kontratës dhe mosparaqitja në vendin e punës, ka rezultuar me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Tutje ka shtuar se nga data e njoftimit të ndryshimit të kontratave për uljen e pagës, e cila ka rezultuar me ndërprerje e deri në ushtrimin e padisë, paditësi ka humbur afatin vijues prej 30 ditësh, që të mundë të inicioj kontest pune në kuptim të nenin 79 të Ligjit të Punës.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetet pranë deklarimeve të kundërshtimeve sikurse në seancat paraprake, meqenëse për rastin në fjalë është vendosur sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Klinë, si dhe sipas Gjykatës së Apelit, deri te marrëveshja jashtëgjyqësore ndërmjet palëve ndërgjyqëse e të gjitha këto vërtetohen edhe ndërmjet provave të administruara në këtë seancë, andaj i ka propozuar gjykatës që të hedhë poshtë si të pa lejuar padinë apo ta refuzoj si të palejuar, meqenëse që nga koha kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës e deri në precizimin e kërkesëpadisë kanë kaluar më tepër se katër vite, andaj këto kërkesa janë të parashkruara konform dispozitave ligjore të Ligjit të Punës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e këtyre provave: kontrata e punës me nr. protokollin 934/15e dt. 02.07.2015, kontrata e punës për kohë të caktuar e dt. 31.12.2015, vendimi nr. 277/16, i dt. 02.02.2016, ankesa me nr. 307./16 e dt. 08.02.2016, email – adresa e dt. 27.01.2016, email adresa e dt. 08.01.2016 me nr. protokollin 25/16 e dt. 08.08.2016, vendimi me nr. 172/16 i dt. 19.01.2016, marrëveshja jashtëgjyqësore me nr. 1620/16 e dt. 14.12.2016, aktgjykimi Cc.NR 62/16 I DT. 15.11.2016, transferi me nr. 1506 i dt. 27.12.2016, ekspertiza financiare e dt. 22.05.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, tash e tutje referuar si “LPK”, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi kishte punuar në pozitën Operator në pikën kufitare në Kullë, deri me dt. 02.02.2016 e që është edhe data prej kur iu kishte ndërprerë marrëdhënia e punës me anë të vendimit nga e paditura me nr. 277/16, i dt. 02.02.2016 Për këtë arsye, gjykata nuk e pa të nevojshme të provojë faktet që janë jokontestuese në mes të palëve.

Kontestuese për palët ndërgjyqëse ishte çështja e ligjshmërisë së vendimit të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit nga e paditura, çështja se e paditura këtë

vendim a e ka marrë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe ky vendim a është i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Nga provat e administruara, përkatësisht kontrata e punës për kohë të caktuar, me numër protokollit 934/15 e datës 02.07.2015 Gjykata vërtetoi se paditësi me të paditurën kishte kontratë të punës për pozitën Operator i shitjes së policave në pikën kufitare Kulla, për periudhën prej 01.07.2015 deri me 30.06.2018. Gjithashtu, nga kjo kontratë gjykata vërtetoi se paditësi kishte pasur pagë bruto në shumë prej 500.00 euro.

Nga kontrata e punës për kohë të caktuar, e datës 31.12.2015, gjykata e vërtetoi faktin se paditësit i ishte ofruar kontratë e re pune, me të gjitha obligimet dhe kohën e caktuar si në kontratën e dt. 15.07.2015, vetëm paga bruto nga 500.00 euro, i kishte zbritur për 400.00 euro, te cilën tani paditësi nuk ka pranuar ta nënshkruaj.

Nga email adresa e dt. 08.01.2016, si dhe ajo e datës 27.01.2016, gjykata e vërtetoi faktin se e paditura kishte kërkuar nga punëtorët përgjegjës që deri me datë 12.01.2016 në ora 16:00 të nënshkruhen të gjitha kontratat e punës së punëtorëve të BKS-s, si dhe kushdo që nuk i nënshkruar këto kontratat, të largohen nga lista e pagave si pasojë e mos nënshkrimit të kontratave të punës.

Nga vendimi i të paditurës me nr. 172/16 i datës 19.01.2016 gjykata e vërtetoi faktin se e paditura ju është drejtuar të punësuarve ti cilëve ju është ndërruar kontrata e punës me propozim nga Komiteti për Financa dhe Buxhet, komitet ky i formuar nga Këshilli Administrativ, duke i obliguar punonjësit të nënshkruajnë kontratat e punës dhe ate deri të nesërmen me date 20.01.2016, në ora 16:00, në të kundërtën merren hapa ligjor për mos respektim të vendimeve të Këshillit Administrativ, që ka rezultuar me nxjerrjen e vendimit nr.277/16 dt. 02.02.2016.

Nga vendimi e të paditurës me nr. 277/16 i datës 02.02.2016 gjykata e vërtetoi faktin se ishte aprovuar refuzimi i paditësit për mos nënshkrimin e kontratës së punës së ofruar, si dhe me këtë vendim, paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Nga ankesa me nr. 307/16 dt. 08.02.2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësi e kishte ankimuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, BKS-së Organit kompetent për shqyrtimin e ankesave.

Me datën 26.04.2023, gjykata në këtë procedurë, në bazë të propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, mori aktvendim me të cilin vendosi që pala paditëse të dëgjohej si palë. Me datën 12.05.2023 u dëgjua paditësi në cilësinë e palës, pranë kësaj gjykate. Paditësi - ndër të tjera - në këtë seancë ka deklaruar se ka punuar tek e paditura për 4 vite me kontratë me afat 3 vjeçar, dhe papritmas nga e paditura i ka ardhur njoftimi që duhet të zbritet paga, mirëpo te cilën nuk e ka nënshkruar dhe si pasojë i është ndërprerë kontrata e punës të cilën e ka pasur me kohe të caktuar .

Gjykata me propozimin e palës paditëse ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare në këtë çështje juridike kontestimore. Nga ekspertiza financiare e përgatitur nga ekspertja financiare M.M.M., e datës 22.05.2023, gjykata ka konstatuar se paditësit në emër të shumës neto për kompensimin e pagave për periudhën prej dt. 02.02.2016 deri e 30.06.2018, i takojnë gjithsejtë 13,041.30 Euro neto, në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumë prej 725.00 euro, në emër të kontributit pensional të punëmarrësit shumë prej 725.00 euro si dhe në emër të tatimit në paga shumë prej 733.00 euro, në lidhje me këtë, gjykata ia fali besimin e

plotë kalkulimeve të bëra nga ekspertja financiar në këtë ekspertizë financiare, pasi që e konsideroi si profesionale dhe të besueshme. Këto kalkulime në ekspertizë, ekspertja financiare i ka prezantuar edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e cila në këtë seancë ka bërë edhe përmirësimin e ekspertizës, e cila ka deklaruar se ka qenë një gabim teknik, në të cilën në faqen 4 të ekspertizës, tek kontributi penisonal shuma është dashur të jetë 725.00, ndërsa gabimi është se është shkruar 750.00 euro, në lidhje me ekspertizën financiare duhet theksuar se përfaqësuesja e autorizuar i të paditurës e kishte deklaruar se kanë vërejtje ndaj së njëjtës, duke marrë parasysh se kundërshtimi i përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës ndaj ekspertizës financiare nuk ishte i arsyetuar dhe mbi të gjitha nuk kishte një propozim të qartë nga ana e palës së paditur sa i përket ekspertizës, gjykata ia fali besimin e njëjtë asaj eksperte si në arsyetimin e dhënë këtu.

Sa i përket provave të administruara në shqyrtimin kryesor dhe atë provat si në vijim: marrëveshja jashtëgjyqësore me numër 1620/16 e datës 14.12.2016, aktgjykimi me numër C.nr.62/16 i datës 15.11.2016, transferi me numër 1506 i datës 27.12.2016, gjykata pasi që i shqyrtoi me kujdes secilën veç e veç erdhi në përfundim se asnjëra prej tyre nuk kanë të bëjnë me çështjen për të cilën është ngritur padia e paditësit dhe secila prej këtyre dokumenteve janë të nxjerra për një kompensim tjetër që nuk i përket kohës dhe çështjes e cilën paditësi referohet në padi dhe kërkesëpadi. Për këtë arsye, ky vendim nuk u bazua në asnjërën prej këtyre provave të paraqitura në këtë paragraf.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës dhe zbatimi i të drejtës materiale

Anulimi i paragrafit të dytë të vendimit të kontestuar

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe e njëjta është aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga provat e administruara Gjykata gjeti se e paditura me rastin e marrjes së vendimit kontestues 277/16 i dt. 02.02.2016, nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë dhe mbi të gjitha, ka zbatuar dispozita të gabuara ligjore të cilat kanë shkaktuar edhe aplikimin e gabuar të procedurës ndaj paditësit.

Gjykata ka vlerësuar se e paditura nuk ka arritur të argumentoj ligjshmërinë ndërprerjes së marrëdhënies së punës së paditësit. Në rastin konkret, e paditura në vendimin e kontestuar është në hyrje të vendimit është thirrur në nenin 72 të Ligjit të Punës, pastaj në arsyetim është thirrur në atë se paditësi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së dt. 31.12.2015, dhe për këtë i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Në lidhje me këtë, gjykata vlerëson se ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit bazuar në këto dispozita dhe këto arsye është bërë në mënyrë të gabuar dhe mbi të gjitha e kundërligjshme.

Nenin 72 të ligjit të punës në të cilin është thirrur e paditura, në marrjen e vendimit është përcaktuar. "Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje. 2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit. 3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. 4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës". E paditura në marrjen e këtij vendimi, nuk ka paraqitur bazë ligjore mbi të cilën e ka marrë vendimin, Gjykata vlerëson se në këtë rast nuk ka mundur që të zbatohet kjo dispozitë ligjore për shkak se, nuk ishte kontestuese koha e paralajmërimit për ndërprerje, kontestuese ishte fakti arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Neni 70 i

Ligjit të Punës përcakton shumë qartë arsyet, shkaqet kur punëdhënësi mundë t'ia ndërpresë marrëdhënia punës të punësuarit nga punëmarrësi dhe atë “ *Neni 70 Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit 1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur: 22 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative; 1.2. i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës; 1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër; 1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në: 1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe 1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës. 1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti; 1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur: 1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim. 2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim. 3. Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t'ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuarit ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet. 4. Marrëveshjet Kolektive ose Aktet e Brendshme të Punëdhënësit mund t'i specifikojnë llojet e keq sjelljeve ose të shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuarit t'i nënshtrohet ndërprerjes të kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve të përsëritura. Dhe në vendimin e saj e paditura, nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e nenit 70 të ligjit të punës, të cilat janë të parapara për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit.*

Andaj, nga të lartcekurat, Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës me rastin e marrjes së vendimit kontestues të lartcekur, andaj vendosi që i njëjti të anulohet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në lidhje me propozimin për hüdhen e padisë si të **pa afatshme**, si dhe pretendimeve se nga koha kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës e deri në precizimin e kërkesëpadisë kanë kaluar më tepër se katër vite, andaj këto kërkesa janë të parashkruara konform dispozitave ligjore të Ligjit të Punës-së, gjykata i konsideroj si pretendime të pa pabazuara, pasi që referuar provave të administruara në Seancën e shqyrtimit kryesor konkretisht ankesës se paditësit me numër 307/16 të datës 08.02.2016, kundër vendimit me numër 277/16 të datës 02.02.2016, për të cilën nuk ka prova se e paditura ka vendosur apo jo në lidhje me këtë ankesë andaj referuar dispozitës se nenit 78 të Ligjit të Punës” *I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh. Ndërsa bazuar ne dispozitën e nenit 79 “ Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk*

merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”, në rastin konkret gjykata vlerëson duke ju referuar datës se ankese e cila nga e paditura është pranuar me date 08.02.2016, për të cilën nuk ka prova nëse është vendos për të njëjtën, ndërsa padi e paditësit ne gjykatë është pranuar me date 09.03.2016, që nënkupton se e njëjta është e afatshme.

Kompensimi i pagave

Duke qenë se e paditura në mënyrë të kundërligjshme ka bërë largimin e paditësit nga puna, të njëjtit i detyrohet t’ia kompensojë pagat për periudhën, aq sa do të kishte afat kontrata me periudhë të caktuar e datës 01.07.2015, e cila periudhë është nga 01.07.2015 deri me 30.06.2018 Duke u bazuar në përllogaritjet e ekspertës financiare, sipas ekspertizës financiare të datës 22.05.2023, dhe atë bazuar në llogaritjet se e paditura ka për obligim që paditësit në emër të pagave, t’ia kompensoj shumat si në vijim: periudhën 02.02.2016 deri me 30.06.2018 t’ia paguaj shumën e përgjithshme neto prej 13,041.30 euro, në emër të kontributit pensional të punësuarit shumën prej 725.00 euro, si dhe në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumën prej 725.00 euro, si dhe në emër të tatimit në pagë shumën prej 733.70 €. Gjykata e aprovoi në tërësi, dhe ia fali besimin në tërësi kalkulimeve të bëra në ekspertizën financiare pasi që gjeti se e njëjta ishte profesionale dhe e bazuar.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kërkesa për kthimin në punë

Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për kthim në vendin e punës, Gjykata gjeti se nuk ka bazë ligjore për kthim në vendin e punës. Kjo për shkak se sipas dispozitave ligjore të nenit 80 par.1.2 parashihet se Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, që do të thotë vetëm nëse kemi të bëjmë me çështjen e diskriminimit në punë. Në rastin konkret nuk është vërtetuar se ka ekzistuar ndonjë formë e diskriminimit me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës,, andaj dhe u vendos si në pikën V. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për më tepër, duke marrë parasysh se në çfarëdo rrethane, edhe në rast se paditësit do t’i vazhdohej kontrata e tij, e njëjta kishte për të skaduar me datën 30.06.2018. Rrjedhimisht, kthimi i tij në vendin e punës nuk mund të bëhet edhe për këtë arsye për shkak se do të bëhej në mungesë të një bazë kontraktuale e që paraqet kriterin bazë për mundësinë e kthimit të punëtorit në vendin e punës.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje.

Kamata dhe shpenzimet e procedurës

Për kamatën e aplikuar gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 382 të LMD-së, duke e llogaritur nga data e pezullimit të paditësit nga vendi i tij i punës tek e paditura.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe Tarifës së OAK-së, ashtu që Gjykata vendosi që e paditura t’ia paguaj paditëses për precizimin e padisë kompensimin në shumë prej 104 Euro, për përfaqësim në tri seanca gjyqësore nga 135 Euro në shumë prej 405, për taksë gjyqësore shumen prej 25 euro si dhe për

ekspertizën financiare shumë prej 150 Euro. Në total gjykata ka urdhëruar të paditurën që paditësit t'i bëj kompensimin e shpenzimeve në vlerë prej 684 Euro. Nga të lartcekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.489/16, datë 29.06.2023

Gjyqtarja,

Kosovare Musliu Prokshaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.